



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 29.10.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkeses për ri-shqyrtim të datës 21.10.2024 të parashtruar nga Operatori Ekonomik MEDPLUS SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **Ritender "Furnizim me Barnave dhe materialit shpenzues të planifikuara për rezidentët e ISSH dhe SHFAKM ne Shtime"** me nr. prokurimi 206-24-10103-1-2-1, nxjerr:

**V E N D I M**

- I. **Pranohet**, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE MEDPLUS SH.P.K. e datës 21.10.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Ritender "Furnizim me Barnave dhe materialit shpenzues të planifikuara për rezidentët e ISSH dhe SHFAKM ne Shtime"** me nr. prokurimi 206-24-10103-1-2-1, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK, të datës 15.10.2024 të publikuar në platformën elektronike;
- II. **Anulohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK, i datës 15.10.2024;
- III. Autoriteti Kontraktues, e kthen në rivlerësim aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**Arsyetim**

Operatori Ekonomik MEDPLUS SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ritender "Furnizim me Barnave dhe materialit shpenzues të planifikuara për rezidentët e ISSH dhe SHFAKM ne Shtime"** me nr. prokurimi 206-24-10103-1-2-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 29.10.2024, ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

**Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:**

Neni 1 i LPP-së  
Neni 6 i LPP-së  
Neni 7 i LPP-së

Neni 56 i LPP-së  
Neni 59 i LPP-së  
Neni 69 i LPP-së  
Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

**Pretendimet ankimore - Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet sipas OE ankues:**

Me dt. 15.10.2024 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK-së, ku është rekomanduar për kontratë **OE BRT Pharm SH.P.K** ndërsa neve na është dërguar letra standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin si në vijim:

Nuk i keni plotësuar kriteret siç janë kërkuar në NJK dhe DT. Oferta juaj është e papërgjegjshme pasi që nuk e keni ofruar. Te Pjesa II, Përshkrimi i Çmimeve, në kolonën Prodhuesi dhe vendi i Origjinës- OE MEDPLUS SH.P.K nuk e ka përshkruar fare Emrin e Prodhuesit me të cilin Oferton, por vetëm emrin e shtetit (Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet).

Sipas UDHËZUESIT Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, neni 10, sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit tregon se, në raste të tilla, Tenderi duhet të refuzohet pa kërkuar informacione të mëtejshme.

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ

Sa i përket arsyes së eliminimit, ju sqarojmë se në këtë rast është dashur të kërkohen sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe kjo çështje do të ishte sqaruar, prandaj në këtë rast ne jemi diskriminuar si operator ekonomik.

Ne kemi pas qasje në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe kemi ardh në përfundim se ky OE është i papërgjegjshëm, madje ka dhënë të dhëna të rrejshme dhe mashtruese dhe kjo vërtetohet si më poshtë:

**Ne paramasë është kërkuar:**

- Nr.55 Epruveta sterile për urine 100ml - është material shpenzues ndërsa OE i rekomanduar për kontrate e ka shenu PMA012/16/11/2016 i cili është për produktin ENAP ® -H Enalapril maleate, Hydrochlorothiazide, prandaj ky veprim i OE është mashtrim.
- Nr.56 Erythromycin forma te forta orale 500mg - është produkt farmaceutik i cili ka AM ndërsa OE i rekomanduar për kontrate e ka shenu PA AM.
- Nr.63 Fluoxetin forma te forta orale 20mg - është produkt farmaceutik i cili ka AM ndërsa OE i rekomanduar për kontrate e ka shenu PA AM.
- Nr.101 Multivitamin effervescent - është suplement Pa AM ndërsa OE i rekomanduar për kontrate e ka shenu numrin e AM te ROJAZOL Miconazole nitrate 20mg/g Cream, edhe ky është një mashtrim nga OE i rekomanduar për kontratë.
- Nr.102 Natrium chloride 0.9% 500ml - është produkt farmaceutik ndërsa OE i rekomanduar për kontrate e ka shenu PA AM, prandaj ky është mashtrim nga an e OE të rekomanduar për kontratë.



- Nr.104 Needle luer disposable 0.8mm x 38mm 21G - Është material shpenzues ndërsa OE i rekomanduar për kontrate e ka shenu numrin e AM te një produkti farmaceutik, prandaj ky është mashtrim nga an e OE të rekomanduar për kontratë.
- Nr.107 Omnistrip 3mm x 79 mm - Është material shpenzues ndërsa OE i rekomanduar për kontrate e ka shenu numrin e AM te një produkti farmaceutik, prandaj ky është mashtrim nga an e OE të rekomanduar për kontratë.
- Nr.110 Pantoprazol forme e forte orale 40mg - është produkt farmaceutik i cili ka AM ndërsa OE i rekomanduar për kontrate e ka shenu PA AM, prandaj ky është mashtrim nga an e OE të rekomanduar për kontratë.
- Nr.141 Vitamin B complex ampulle - OE i propozuar për kontrate e ka shenu prodhuesin YASENKA CROATINA - Ndërsa sipas listës se AKPPM prodhues është DEMO S.A, PHARMACEUTICALS INDUSTRY, GREEC, prandaj ky është mashtrim nga an e OE të rekomanduar për kontratë.

Nga këto dëshmi shihet që OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe për më tepër ka ofruar deklarata dhe dëshmi mashtruese dhe të rrejshme, prandaj është dashur të eliminohet.

Produktet të cilat kanë AM shumë lehtë mund të vërtetohen dhe verifikohen në listën e AKPPM-së prandaj ju lutem verifikoni këto të dhëna.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë, konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse ne jemi eliminuar pa të drejtë edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, sepse ne jemi operator ekonomik i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.

Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, ndërsa neve jemi diskriminuar duke u eliminuar pa të drejtë në këtë aktivitet të prokurimit.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së, e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Kurse paragrafi 6 pika vi parasheh që "që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse", ndërsa oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk është në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

## **VENDIM**

**APROVOHET**, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE **MEDPLUS SH.P.K**

**ANULOHET**, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) dhe lënda kthehet në

RISHQYRTIM dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

#### 8. Dëmet materiale

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

#### Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet Ankimore te OE ankues:

E kemi shqyrtuar Kerkesen tuaj per rishqyrtim dhe konsiderojme se pretendimet e juaja jane te bazuara.

Sipas Dosjes se Tenderit, te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ne kriterin nr. 2 eshte kerkuar:

**2. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se secili produkt në listën për tenderim, ka Autorizim për Marketing në Kosovë. Ky kriter nuk vlene per artikujt e materialit shpenzues.**

Dhe deshmia:

**2. OE duhet të dëshmojë se secili produkt në Listën e produkteve me të cilën oferton, është i regjistruar në Regjistrin e produkteve të regjistruara në AKPPM, në kohën e ofertimit, me numrin e Autorizim marketingut. Ky kriter nuk vlejne për artikujt e materialit Shpenzues.**

OE i rekomanduar ne Pershkrimin e Çmimeve nuk i ka plotësuar siç duhet AM per artikujt e barnave, ndersa ju si OE ankues i keni plotësuar te gjitha AM-te per artikujt e barnave.


Çeshtja kontestuese te Pershkrimin e Çmimeve qe ju e keni ofruar eshte per mosplotesimin e kolones Prodhuesi dhe Vendi i origjines vetem te artikujt e materialit shpenzues medicinal.

Pas shqyrtimit te ankeses tuaj, duke marre parasysh se ne kriterin e lartcekur eshte specifikuar se ... **Ky kriter nuk vlene për artikujt e materialit Shpenzues** dhe çeshtja e Prodhuesit dhe Vendi i origjines nuk eshte kerkese e kualifikimit ne FTD, si dhe faktin se oferta juaj financiare eshte me çmimin me te lirë, ne si AK-MSh u japim te drejte juve si OE ankues dhe lenda kthehet ne rivleresim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

#### Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit